



Thirrje për Projekt Ide Vatra e Biodiversitetit të Pellgut të Mesdheut

Grantet e Vogla në Ballkan

**Vendet e përzgjedhura
për këtë thirrje:**

Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut

Data e hapjes:

e hënë 1 shkurt 2021

**Afati i fundit i dërgimit
të aplikimeve:**

e premte 26 Shkurt 2021, ora 23:59

**Shuma për të cilën
mund të aplikohet:**

nga 5,000 (pesë mijë) USD deri në 30,000 (tridhjet mijë) dollarë amerikanë (USD) për grant

Afatet e zbatimit të projekteve:

Projektet duhet të fillojnë jo më herët se data 1 maj 2021 dhe duhet të përfundojnë brenda datës 30 prill 2022.

CEPF dhe BirdLife International, që shërbejnë si [Ekip Rajonal i Zbatimit të Projekteve](#) (RIT) për Vatrën e Biodiversitetit të Pellgut të Mesdheut, ftojnë organizmat privatë (jo qeveritarë) të dërgojnë propozimet e tyre në formën e Projekt Ideve (LOI) në linjë me qëllimin e kësaj thirrje. Aplikantët këshillohen që të lexojnë plotësisht këtë dokument përpara se sa të fillojnë shkrimin e projekt idesë.

HISTORIKU

Fondi i Partneritetit për Ekosistemet e Kërcënuara (CEPF) është një iniciativë e përbashkët e Agjencisë Franceze të Zhvillimit, Organizatës “Conservation International”, Bashkimit Evropian, Fondit Botëror për Mjedisin¹, Qeverisë Japoneze dhe Bankës Botërore. Një prej qëllimeve themelore të CEPF është të sigurojë angazhimin e shoqërisë civile në ruajtjen e biodiversitetit.

Vatra e Biodiversitetit të Pellgut të Mesdheut është e dyta në botë për nga madhësia dhe më e madhja ndër pesë rajonet e klimës mesdhetare. Investimet e CEPF në Mesdhe janë udhëzuar përmes një procesi me pjesëmarrje që angazhoi grupe interesi nga shoqëria civile, qervertë, dhe donatorë nga të gjitha vendet e rajonit. Në bazë të kësaj qasje u hartua strategjia e investimeve (2017 – 2022) për këtë rajon, e cila mund të gjendet [këtu \(PDF – 31 MB\)](#). Kjo strategji investimi përfshin një sërë drejtimesh strategjike, të ndara në prioritetet investimi, duke përfshirë llojet e aktiviteteve të pranueshme për financim nga CEPF.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Organizatat joqeveritare, grupet e komunitetit, universitetet dhe ndërmarrjet private mund të aplikojnë për fonde. Individët, duhet të punojnë me organizatat e shoqërisë civile për të zhvilluar aplikimet e tyre dhe jo të aplikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

¹ Global Environment Facility (GEF)

Organizatat duhet të kenë llogarinë e tyre bankare dhe të jenë të autorizuar sipas ligjeve të vendit përkatës për marrjen donacioneve apo granteve të bamirësisë.

Ndërmarrjet ose institucionet në pronësi të qeverisë lejohet të aplikojnë vetëm nëse mund të vërtetojnë se kanë:

- status ligjor të pavarur prej ndonjë agjencie apo zyrëtari të qeverisë;
- autoritetin të aplikojnë dhe pranojnë fonde private; dhe
- nuk mund të shpallin pavarësinë nga agjencia përkatëse qeveritare.

Grantet nuk mund të përdoren për:

- blerjen e tokës, zhvendosjen e pavullnetshme të njerëzve, ose aktivitete që kanë ndikim negativ në burimet kulturore, veçanërisht ato që janë të rëndësishme për komunitetet vendase.
- aktivitete që dëmtojnë komunitetet indigjene aty ku këto të fundit nuk kanë shprehur gjerësisht përkrahjen e tyre kundrejt këtyre nismave.
- heqjen ose tjetërsimin fizik të ndonjë objekti të pasurisë kulturore (përfshirë këtu objekte të luajtshme ose të paluajtshme, vende, struktura, veçori natyrore dhe peizazhe që kanë rëndësi arkeologjike, paleontologjike, historike, arkitektonike, fetare ose vlera natyrore unike).

Aktivitetet e propozuara duhet të respektojnë të gjitha politikat e tjera mbrojtëse dhe shoqërore që mund të gjenden në [faqen e internetit të CEPF](#).

AKTIVITETET E LEJUESHME

Shtrirja e kësaj thirrje është e kufizuar në llojet e aktiviteteve dhe vendet e përkrahura më poshtë.

Projekt Idetë do të pranohen vetëm për Drejtimet Strategjike të poshtëshënuara:

- **Drejtimi Strategjik 2:** “Mbështetja e menaxhimit të qendrueshëm të ujëmbledhësve nëpërmjet qasjes së integruar për ruajtjen e larmisë biologjike të kërcënuar të ujrave të ëmbla”

Vendi i përzgjedhur për këtë Drejtim Strategjik: Mali i Zi

Zona për të cilën duhet të propozohen projekt idetë: Ujëmbledhësi përreth Nikshiçit

- **Drejtimi Strategjik 3:** “Përkrahja e praktikave tradicionale të përdorimit të tokës, të nevojshme për ruajtjen e larmisë biologjike të Mesdheut, në korridoret kryesore me vlera të larta kulturore dhe të biodiversitetit”

Habitatet dhe praktikat tradicionale të përzgjedhura për këtë thirrje: kullotat dhe pastoralizmi

Vendet e përzgjedhura për këtë Drejtim Strategjik: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut

Zona për të cilën duhet të propozohen projekt idetë: Adriatiku Lindor dhe Ballkani Jugperëndimor

Projektet duhet të zbatohen brenda ose në afërsi të Zonave Kryesore të Biodiversitetit (KBA) të korridoreve të sipërpërmendur, në mënyrë që të mborohet sa më shumë biodiversiteti i rrezikuar. Lista e KBA-ve jepet në [profilin e ekosistemit](#) (faqe 42-51) dhe një hartë e hollësishme është gjithashtu e arritshme në faqen e [internetit të CEPF](#).

Projektet e propozuara duhet të jenë në linjë ose Drejtimin Strategjik 2 ose me Drejtimin Strategjik 3. Nëse dëshironi të aplikoni për të dy Drejtimet Strategjike, duhet të plotësoni një Projekt Ide të veçantë për secilin.

Projekt idetë duhet të kenë në themel ruajtjen e larmisë biologjike dhe të sjellin përmirësim apo ndikim pozitiv në gjendjen e ruajtjes së biodiversitetit.

Kur është e nevojshme, aplikantët inkurajohen të paraqesin Projekt Ide të cilat harmonizohen me nismat ekzistuese kombëtare ose rajonale. Sinergjitë me organizata të tjera janë gjithashtu të pranueshme, ku një prej organizatave është në rolin kryesor dhe paraqet kërkesën dhe organizatat e tjera janë partner në projekt dhe kanë role të qarta dhe të deklaruara në Projekt Ide.

Aplikantët nga vendet jashtë listës së vendeve të lejueshme për këtë thirrje, mund të paraqesin një Projekt Ide për sa kohë që produktet e dorëzueshme të projektit i përgjigjen nevojës për ruajtjen e biodiversitetit të prej vendeve të përzgjedhur për këtë thirrje. Organizatat ndërkombëtare inkurajohen të përfshijnë organizata lokale ose komunitete, si partnerë të projektit dhe/ose të shpjegojnë se si palët e interesuara vendase do të angazhohen në zbatimim e projektit.

Tabela 1. Drejtimit Strategjike dhe Prioritetet e Investimeve në të cilat kjo thirrje përqëndrohet [ju lutemi shikoni Shtojcën 1 për udhëzime dhe këshillime të mëtejshme]

Drejtimi Strategjik	Priority i Investimit / zonat kyç
<p>Drejtimi Strategjik 2: Mbështetja e menaxhimit të qendrueshëm të ujëmbledhësve nëpërmjet qasjes së integruar për ruajtjen e biodiversitetit të kërcënuar të ujrave të ëmbla.</p> <p><i>Shuma e kërkuar për çdo projekt duhet të jetë nga 5,000 deri në 30,000 dollarë amerikanë (USD). Shuma e përgjithshme në dispozicion për këtë Drejtim Strategjik është 60,000 dollarë amerikanë (USD)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Prioriteti i Investimit 2.1: Përmirësimi i bazës së njohurive mbi biodiversitetin dhe rëndësinë e shërbimeve të ekosistemit të ujërave të ëmbla. • Prioriteti i Investimit 2.2: Ndërmarrja e veprimeve për të ulur kërcënimet dhe për të përmirësuar menaxhimin e zonave të përzgjedhura të ujëmbledhëve të ujrave të ëmbël me pjesëmarrjen e palëve vendase të interesit. • Prioriteti i Investimit 2.3: Angazhimi me qeverinë, sektorin privat dhe palët e tjera të interesit për të mbështetur praktikatat e integruara të menaxhimit të baseneve lumore që ulin kërcënimet ndaj biodiversitetit në Zonat e Menaxhimit të Ujëmbledhësve (CMZ). <p>Ju lutemi shihni Shtojcën 1 për udhëzime dhe këshillime të mëtejshme</p>
<p>Drejtimi Strategjik 3: Përkrahja e praktikave tradicionale të përdorimit të tokës, të nevojshme për ruajtjen e larmisë biologjike të Mesdheut, në korridoret kryesore me vlera të larta kulturore dhe të biodiversitetit.</p> <p><i>Shuma e kërkuar për çdo projekt duhet të jetë nga 5,000 deri në 30,000 dollarë amerikanë (USD). Shuma e përgjithshme në dispozicion për këtë Drejtim Strategjik është 90,000 dollarë amerikanë (USD).</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Prioriteti i Investimit 3.1: Mbështetja e komuniteteve lokale për të rritur përfitimet që mërrhen nga mirëmbajtja dhe përmirësimi i përdorimit të tokës dhe praktikave bujqësore tradicionale, miqësore me biodiversitetin. • Prioriteti i Investimit 3.2: Të përkrahët ndërgjegjësimi mbi vlerën e praktikave tradicionale të përdorimit të tokës, që janë miqësore me biodiversitetin, midis komuniteteve lokale dhe vendimmarrësve, për të siguruar njohjen dhe mbështetjen e tyre. • Prioriteti i Investimit 3.3: Inkurajimi i aktorëve të biznesit në zinxhirin tregtar për të mbështetur dhe promovuar praktikatat tradicionale të përdorimit të tokës që janë miqësore kundrejt biodiversitetit. <p>Ju lutemi shihni Shtojcën 1 për udhëzime dhe këshillime të mëtejshme</p>

COVID-19

COVID-19 është ka sjellë një ndikim serioz në komunitetet rurale dhe nevoja për t'i mbështetur ato në këtë kohë është edhe më e madhe. CEPF mirëpret sismat në kuadër të këtyre projekteve, që trajtojnë këto çështje, për sa kohë qëndrojnë në përputhje me kriteret e përshkruara më poshtë.

PROCESI I APLIKIMIT

Projekt Idetë (LOI) mund të shkruhen në gjuhët: **angleze, serbe, kroate, malazeze, maqedonase dhe shqiptare.**

Ju lutemi **shkarkoni formularin e LOI** në gjuhën që dëshironi*:

- [Anglisht](#)
- [Serbokroatisht](#)
- [Shqip](#)

* Për Projekt Idetë e shkruara në gjuhën maqedonase, ju lutemi përdorni njërin prej tre formularëve më lart.

Aplikantët duhet të dërgojnë Projekt Idenë e tyre brenda afatit, në adresën CEPF-MED-RIT@birdlife.org

Një email konfirmues dhe falënderues nga RIT do t'ju dërgohet pas dërgimit të Projekt Idesë.

Procesi i rishikimit dhe kontraktimit të Projekt Ideve do të zgjasë përafërsisht tetë javë nga data e mbylljes së thirrjes. Komiteti i shqyrtimit do të zgjedhë Projekt Idetë më të mira, që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë më sipër. Të gjithë aplikantët do të marrin një përgjigje nga RIT pas shqyrtimit të Projekt Ideve të tyre.

Aplikantëve që kalojnë me sukses fazën e parë të shqyrtimit të Projekt Ideve, do t'u kërkohet shtjellimi dhe zhvillimi i tyre në një fazë të dytë, ku buxheti dhe kuadri logjik duhet të detajohen. Projekt Idetë fituese do të kontraktohen midis organizatës BirdLife International (nën kornizën e Ekipit Rajonal të Zbatimit për Vatrën e Biodiversitetit të Pellgut të Mesdheut) dhe organizatës aplikuese ("përfitues të grantit"). Grantet do të shprehen në dollarë amerikanë (USD) dhe marrëveshja e granteve do të jetë në gjuhën angleze.

MATERIALET E REFERIMIT

Të gjithë aplikantët këshillohen të shfletojnë Strategjinë e Investimeve të CEPF për Pellgun e Mesdheut sipas profilit të ekosistemit. Këtu jepen më shumë detaje mbi llojet e aktiviteteve që CEPF financon nën secilin prioritet investimi:

- Profili i Ekosistemit: [anglisht](#) (PDF – 16 MB)
- Përmbledhje Teknike e Profilit të Ekosistemit: [anglisht](#) (PDF – 2.2 MB)

Një hartë interaktive e Vatrës së Biodiversitetit të Mesdheut mund të gjendet [këtu](#); përdorni ikonën në të djathtë lart "List Layer" për të zgjedhur shtresën që dëshironi të shihni.

CEPF është i angazhuar në integrimin e çështjeve gjinore në portofolin e tij. Aplikantët duhet të hartojnë projekte dhe të shkruajnë propozime që marrin në konsideratë çështjet gjinore në arritjen e objektivave të ruajtjes. CEPF ka zhvilluar disa mjete që mund të ndihmojnë aplikantët të hartojnë, zbatojnë dhe të vlerësojnë projekte, duke mbajtur në vëmendje çështjet gjinore ([CEPF Gender Toolkit](#), PDF – 359 KB) dhe të kuptojnë se çfarë kërkon CEPF në një propozim ([CEPF Gender Fact Sheet](#), PDF – 352 KB). Vizitoni [këtë faqe](#) për të mësuar më shumë se si CEPF trajton çështjet gjinore në projektet që mbështet. Integrimi i çështjeve gjinore në projektin tuaj do të jetë objekt vlerësimi.

Dokumenta ndihmues:

- [Pranueshmëria dhe mënyra e aplikimit](#)
- [Politikat për Masat e Parandalimit apo Mbrojtjes](#)
- [CEPF dhe Kushtet e Barazisë Gjinore](#)
- [12 Këshilla për të Rritur Shancet e Financimit të Projekt Idesë Tuaj](#)
- [Faqja e Projekteve të CEPF](#)

KONTAKTET

Aplikantët inkurajohen të diskutojnë më përpara idetë dhe përshtatshmërinë e tyre në kuadër të kësaj thirrje me:

- Koordinatorin e Granteve të Vogla për Ballkanin, Marijana Demajo; marjana.demajo@pticesrbije.rs
- Ndihmës Koordinatorin e Granteve të Vogla për Shqipërinë, Mirjan Topi; mirjan.topi@pticesrbije.rs

Për pyetje të përgjithshme në lidhje me Programin e CEPF në Vatrën e Biodiversitetit të Pellgut të Mesdheut, ju lutemi kontaktoni Menaxherin e Grante të Vogëla Salwa Elhalwani në Salwa.Elhalwani@birdlife.org ose vizitoni www.birdlife.org/cepf-med.

Figura 1: Harta e korridorit të CEPF për Ballkanin



Me kontur të kafejtë - Korridoret me Përparësi për këtë thirrje; Me kontur të gjelbër – Zonat Kryesore të Biodiversitetit; Eastern Adriatic – Adriatiku Lindor; Southëest Balkans – Ballkani Jugperëndimor;

SHTOJCA 1

I) Udhëzime për Projekt Ide që dërgohen nën Drejtimin Strategjik 2

Gati një e treta e llojeve të Rrezikuara në Mënyrë Kritike që gjenden në këtë vatër biodiversiteti janë kafshë dhe bimë të ujërave të ëmbla. Nevoja për ujë të ëmbël për bujqësi dhe konsum njerëzor është një nga arsyet kryesore që vërteton nevojën e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Në të njëjtën kohë, ekosistemet e ujërave të ëmbla në vatrën e biodiversitetit në fjalë janë të përfaqësuara dobët në rrjetet kombëtare të zonave të mbrojtura dhe janë nën presion nga mbishfrytëzimi dhe ndotja, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë larminë biologjike të tyre. Ndryshimi i klimës ka të ngjarë që t'i përkeqësojë më tej këto probleme.

Mbështetja financiare e CEPF do të adresojë nevojën për të përmirësuar njohuritë mbi vendet e rëndësishme për biodiversitetin e ujërave të ëmbla, duke e përdorur këtë si një mundësi për të rritur kapacitetet në fushën e kërkimeve dhe veprimeve të ruajtjes mbi jetën e egër të ujërave të ëmbla. Përtej kësaj, financimi do të përqendrohet gjithashtu në veprime të bazuara in-situ, duke punuar me palët e interesuara vendase dhe atyre të qeverisjes dhe sektorit privat për të siguruar ndërveprim në zonat përkatëse të zbatimit të projekteve.

Fusha karstike Niksiç dhe rrethina e saj është një vend i rëndësishëm për biodiversitetin në nivel global, me avifaunë, iktiofaunë, florë dhe biodiversitet nëntokësor shumë të pasur. Kjo zonë ende nuk është hulumtuar mjaftueshëm. Megjithatë, përmbush kriteret për t'u njohur si zonë Natura 2000 në bazë të rezultateve të përfutura nga një fazë kërkimore paraprake për avifaunën, ndonëse kërkim plotësues nevojitet edhe për taksat e tjera. Zona ndodhet afër qytetit të dytë më të madh të Malit të Zi, Niksiçit, dhe kësaj është nën një varg të tërë kërcënimesh të drejtpërdrejta (ndërhyrje hidrologjike, urbanizim, copëzim i habitateve, gjuetia e paligjshme e shpendëve, menaxhimi i dobët i mbetjeve, ndotja, etj.). CEPF pret të mbështesë projekte që pritet të sjellin dobi për mbrojtjen e kësaj zone në të ardhmen.

II) Udhëzime për Projekt Ide që dërgohen nën Drejtimin Strategjik 3

Biodiversiteti i Mesdheut ka evoluar për disa mijëra vjet me radhë së bashku me praktikën e përdorimit të tokës të zbatuar nga njerëzit. Kësisoj, shumë prej llojeve tokësore më të kërcënuara të kësaj vatre të biodiversitetit varen nga habitatet që mirëmbahen përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme të njeriut nëpërmjet aktivitetit bujqësor, kullotjes sezonale ose vjeljes së produkteve të egra.

Llojet që varen nga këto sisteme antropogjene mund të kërcënohen kur një sistem menaxhimi braktiset. Kësisoj, ndodh tejtersimi apo zëvendësimi e bimësisë, në rastet kur praktikën e qëndrueshme tradicionale ndryshojnë dhe kjo sjell degradim apo erozion (p.sh., kullotja e tepërt). Njësoj ndodh kur praktikën moderne të bujqësisë dhe përdorimit të tokës, duke përfshirë këtu vaditjen dhe përdorimin e agrokimikateve, zëvendësojnë praktikën tradicionale dhe mënjanojnë mundësinë që jeta e egër të bashkëjetojë me sistemet bujqësore. Më shumë informacion mbi këto çështje mund të gjendet në dokumentin e [profilit të ekosistemit](#).

Shkaqet për këto ndryshime janë të shumta, komplekse dhe të ndërthurura, me pasoja negative për biodiversitetin, jetesën dhe kulturën. Disa faktorë kryesorë të përbashkët në zonat e përzgjedhura nga CEPF në Mesdhe që kanë ndikimin më të madh janë dalluar si:

- Qëndrueshmëria ekonomike: Sistemet tradicionale të prodhimit, zakonisht kërkojnë punë intensive dhe mund të jenë më pak produktive (të paktën për prodhim afatshkurtër). Megjithatë produktet mund të kenë një cilësi të mirë organoleptike, nivel të ulët të mbetjeve të pesticideve, etj., këto veçori për fat të keq u njihen pak apo nuk u njihen në treg, janë me çmim të ulët ose kanë qasje të kufizuara në tregje, pra, të ardhurat e fermerëve mbeten të kufizuara.
- Politikën kombëtare ose rajonale të planifikimit të përdorimit të tokës: Në shumë raste, stimujt dhe rregulloret pengojnë mirëmbajtjen e sistemeve tradicionale dhe rëndësia e biodiversitetit nuk merret parasysh (përfshirë mungesën e përgjithshme të njohjes së shërbimeve të ekosistemit).

Nën këtë drejtim strategjik (Tabela 1), CEPF synon të mbështesë OSHC-të për të punuar me përdoruesit e tokës në komunitetet lokale dhe bizneset lokale për të udhëçelur mënyra të reja për mbështetjen e praktikave tradicionale të përdorimit të tokës që janë të rëndësishme për biodiversitetin. **Interes i veçantë në këtë thirrje i jepet propozimeve që përqendrohen tek kullotat dhe pastoralizmi.**

CEPF përdor korridore për të përqendruar investimet (Figura 1); këto u identifikuan bazuar në praninë e llojeve endemike shumë të kërcënuara, sigurimin e shërbimeve kryesore të ekosistemit, rëndësinë në ruajtjen e rezistencës së ekosistemit dhe aftësinë për të mbrojtur shëndetin dhe integritetin biologjik të vatrës së biodiversitetit.

COVID-19 ka patur një ndikim serioz në komunitetet rurale dhe nevoja për t'i mbështetur ato në këtë kohë është edhe më e madhe. CEPF mirëpret nismat për të trajtuar këto çështje për sa kohë që ato qëndrojnë në përputhje me kriteret e përshkruara më poshtë.

Që të kenë sukses, aplikantët duhet të paraqesin Projekt Ide që të plotësojnë disa prej kriterëve të mëposhtme:

- Të tregojnë një përfitim të qartë për ruajtjen e biodiversitetit, veçanërisht për llojet e rralla ose të kërcënuara (ju lutemi përfshini emrat shkencorë të llojeve).
- Të jenë me dhe për të mirën e komunitetit (jo individëve).
- Të angazhohen me qeveritë lokale (bashki, komuna, prefektura) të nxisin interes dhe të mbështesin autoritetet, aty ku është e nevojshme.
- T'i kushtojnë vëmendje brezit të ri dhe të synojnë që projekti të kontribuojë për ta bërë stilin e jetës në zonat rurale më tërheqës (p.sh., përmes krijimit të vendeve të punës, duke kombinuar praktikat tradicionale, kulturën, artet, etj.).
- Të marrin në konsideratë çështjet gjinore në përcaktimin e përfshirjes dhe përfituesve nga projekti ([Udhëzimet e CEPF për çështjet gjinore](#)).
- Të marrin në konsideratë ndërhyrjet e sugjeruara në seksionin e këshillimit më poshtë.
- T'i referohen projekteve të mëparshme mbi praktikat tradicionale në rajon, të mbështetura nga donatorë të tjerë.

Këshilla

CEPF pret projekt propozime që integrojnë veprime nga 3 shtyllat kryesore të mëposhtme:

- Shtylla e politikave: mbështetja e integritit të aktiviteteve të projektit për zhvillimin e qëndrueshëm që sjell dobi për biodiversitetin dhe planifikimin e duhur të përdorimit të tokës.
- Shtylla Ekonomike: sigurimi i qëndrueshmërisë përmes një qasje ekonomike, rritja e të ardhurave të gjeneruara nga produktet e prodhuara nëpërmjet praktikave tradicionale dhe praktikave të qëndrueshme dhe miqësore me biodiversitetin.
- Shtylla Praktike: inkurajimi i praktikave të përgjegjshme për biodiversitetin.

Idetë për Shtyllën e Politikave:

- Inkurajoni ndërveprimin e nevojave për ruajtjen e biodiversitetit me mirëmbajtjen e praktikave tradicionale, duke përfshirë menaxhimin e burimeve të përbashkëta (p.sh. kullotat), në politikat më të larta të planifikimit të territorit ose ligjeve dhe akteve nënligjore.
- Përmirësoni dhe zhvilloni marrëveshje administrimi ose ruajtjeje midis palëve kryesore të interesit dhe përdoruesve të tokës që përfshihen në praktika të qëndrueshme.
- Mbështetni politikat dhe planet kombëtare, rajonale, lokale dhe sektoriale për të përmirësuar mirëmbajtjen në formë tradicionale të kullotave dhe përdorimin e integruar të burimeve të tyre.

- Mbështetni sistemet tradicionale të qeverisjes për menaxhimin e burimeve të përbashkëta siç janë uji (për kafshët dhe njerëzit), kullotat (p.sh. hyrja në toka të përbashkëta, sistemet e transhumancës etj).
- Zhvillimi i skemës së subvencioneve për praktikat tradicionale miqësore me biodiversitetin dhe punoni për miratimin e tyre nga institucionet përkatëse.
- Mbështetni kapacitetet për nismat e zhvillimit rural, posaçërisht të lidhura me kullotat dhe pastoralizmin.

Idetë për Shtyllën Ekonomike:

- Analizoni zinxhirët e vlerave dhe tregjet e produkteve që prodhohen nëpërmjet praktikave tradicionale dhe komunikoni gjetjet te komunitetet dhe përdoruesit e tokës në mënyrë që ata të mund të fillojnë ndryshimet.
- Realizoni studime mbi aktivitetet e propozuara që zhvillojnë potencialin ekonomik të produkteve që vijnë nga praktikat tradicionale.
- Mbështetni idetë e biznesit lokal duke synuar rritjen e vlerës së produkteve të kullotave.
- Inkurajoni bashkëpunimin e fermerëve për të rritur konkurrencën e tyre të përbashkët në treg.
- Promovoni përdorimin e përgjegjshëm të varieteteve të bimëve vendase ose racave lokale të kafshëve në restorante dhe në tregun e turizmit.
- Mbështetni zhvillimin e investimeve në agroturizëm dhe turizmin natyror.
- Mbështetni qasjet inovative për praktikat bujqësore me përgjegjësi mjedisore përmes ripërtëritjes ose risjelljes së praktikave tradicionale.

Idetë për Shtyllën Praktike:

- Studioni lidhjen midis biodiversitetit dhe praktikave kulturore.
- Mirëmbani dhe rehabilitoni veçoritë e peizazhit - të tilla si gardhe, mure guri ose lera - për të krijuar hapësira dhe mikrohabitata që i shërbejnë jetës së egër dhe gjësë së gjallë.
- Edukoni dhe ndërgjegjësoni rreth praktikave të menaxhimit dhe konrollit të zjarreve në kullota.
- Mbështetni sistemet tradicionale të qeverisjes dhe praktikat më të mira për menaxhimin e burimeve të përbashkëta siç janë uji, kullotat dhe bimët e egra (aromatike dhe/ose medicinale).
- Zhvilloni edukimin dhe ndërgjegjësimin brenda sektorit të bujqësisë për rëndësinë e biodiversitetit në peizazhin baritor.
- Përgatitja e një dokumenti të përgjithshëm udhëzues për nevojat e menaxhimit të peizazhit kulturor baritor.